



**ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVA BAR ASSOCIATION**

Në pajtim me nenet 42. par. 2, nenin 50 dhe 51 të Ligjit për avokatinë nr. 04/L-193, lidhur me nenin 73 të Statutit të OAK-së, Kuvendi i Odës së Avokatëve të Kosovës në mbledhjen e vet të rregullt, të mbajtur më 16 nëntor 2013, miraton si në vijim:

RREGULLORE PËR PROCEDURËN DISIPLINORE NË ODËN E AVOKATËVE TË KOSOVËS

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1 Hyrje

1. Në pajtim me Ligjin për avokatinë dhe me statutin e OAK-së, me këtë Rregullore përcaktohet procedura disiplinore për avokatët dhe praktikantët e avokatisë.

Neni 2 Përkufizimet

“Ankues” do të thotë personi fizik apo juridik duke përfshirë Zyrën e Prokurorit Disiplinor, i cili parashtron fletëparaqitjen.

“Procedura disiplinore” përfshinë pranimin e fletëparaqitjes, hetimin dhe procedimin e fletëparaqitjes, zhvillimin e procedurës disiplinore në Komisionin Disiplinor dhe procedurën në Komisionit për Ankesa .

“Arsye e bazuar” do të thotë ajo arsye, e cila konstatohet se ekziston pas një hetimi të arsyeshëm, përmes të cilit edhe një person i tretë do të beson se avokati apo praktikanti ka bërë vepër apo vepra që paraqesin shkelje të sjelljes profesionale dhe për të cilat parashihet shqiptimi i masës disiplinore.

OAK – është shkurtesa për Odën e Avokatëve të Kosovës.

“Shkelja e sjelljes profesionale” përfshinë:

1. Veprat apo lëshimet e avokatit apo praktikantit, qofshin të bëra individualisht apo në bashkëveprim me personin a personat e tjerë, përmes të cilave shkelet një apo më shumë standarde, të parapara në Ligjin për avokatinë, në Statutin e OAK-së, në këtë Rregullore dhe (apo) në Kodin e etikës profesionale.

2. Shkeljen e çfarëdo urdhri apo vendimi disiplinor.
3. Marrjen me profesion gjatë periudhës së pezullimit apo të suspendimit.

“I paraqituri” do të thotë secili avokat apo praktikant i avokatisë, i cili i nënshtrohet fletëparaqitjes, ankesës apo procedurës disiplinore.

“Mase disiplinore” do të thotë:

1. Vërejtje,
2. Gjobë,
3. humbja e të drejtës së ushtrimit të avokatisë për kohë të caktuar
4. humbja e përhershme e të drejtës së ushtrimit të avokatisë
5. çregjistrimi nga regjistri i praktikantëve për kohe të caktuar
6. çregjistrimi i përhershëm nga regjistri.

Neni 3 Organet disiplinore

1. Organet disiplinore janë si në vijim:
 - 1.1. Zyra e prokurorit disiplinor
 - 1.2. Komisioni Disiplinor
 - 1.3. Komisioni për Ankesa

Neni 4 Pavarësia e Organeve Disiplinore

1. Organet Disiplinore veprojnë në mënyrë të pavarur dhe të paanshme.
2. Asnjë person nuk ka të drejtë të ushtrojë apo të tentojë të ushtrojë ndikim, qoftë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, ndaj Organeve Disiplinore të OAK-së.

Neni 5 Gjuha dhe përkthimi

1. Procedurat disiplinore realizohen nga Organet Disiplinore në njëren prej gjuhëve në përdorim zyrtar në Kosovë.
2. Secili ankues, i paraqitur dhe dëshmitar duhet të njoftohet për të drejtën e tij për të komunikuar dhe dhënë dëshminë në gjuhë të vet. Nëse gjuha e vet dallon nga gjuha e zhvillimit të procedurës disiplinore, atij do ti sigurohet përkthyes në shpenzime të OAK-së, përveç nëse ai me vetëdije nuk e shfrytëzon këtë të drejtë. Çdo mosshfrytëzim i kësaj të drejte bëhet me shkrim dhe futet në procesverbal të seancës dëgjimore.

Neni 6 Ruajtja e dosjes

1. OAK mban dosjen e procedurave të hapura dhe të mbyllura disiplinore, të shënuar në mënyrë alfabetike për të gjithë anëtarët e tanishëm dhe ish-anëtarët.
2. Dosja përfshinë:
 - 2.1. Emrin e avokatit, adresën e zyrës së tij dhe datën kur avokati është regjistruar në OAK;

- 2.2. Datën e fillimit të procedurës disiplinore kundër avokatit;
 - 2.3. Datën e hyrjes në fuqi të vendimeve disiplinore të formës së prerë kundër avokatit;
 - 2.4. Natyrën e vendimit dhe, në rast se është konstatuar përgjegjësia e avokatit për shkelje disiplinore, masave disiplinore;
 - 2.5. Datën kur masa disiplinore do të shlyhet nga dosja e avokatit.
3. Masa disiplinore shlyhet nga dosja e avokatit nëse për shkelje të ngjashme disiplinore nuk është shqiptuar ndonjë masë tjetër brenda tri (3) viteve nga vendimi i fundit.
 4. Pavarësisht paragrafit 3 të këtij neni, përjashtimi i përhershëm nga ushtrimi i profesionit juridik regjistrohet në mënyrë të përhershme.

Neni 7 Qasja në dosje

1. Çdo qytetar mund të kërkojë kopje të dosjes disiplinore të avokatit i cili e përfaqëson atë.
2. Pas pranimit të kësaj kërkesë, OAK jep kopjen e dosjes, ku përfshihet lista e sanksioneve të shqiptuara kundër avokatit, me kusht që këto sanksione të jenë klasifikuar si publike dhe të mos jenë shlyer nga dosja e avokatit.
3. OAK jep kopjen e dosjes brenda pesë (5) ditëve të punës pas pranimit të kërkesës.

Zyra e prokurorit disiplinor

Neni 8 Hyrje

Zyra e prokurorit disiplinor themelohet si organ i ndarë dhe i pavarur që i shërben OAK-së.

Neni 9 Përgjegjësitë

1. Zyra e prokurorit disiplinor është përgjegjës:
 - 1.1 për pranimin dhe shqyrtimin e çdo fletëparaqitje ndaj avokatit apo praktikantit të avokatisë duke përfshirë iniciimin dhe shqyrtimin ex-officio të rastit;
 - 1.2 për përcaktimin nëse Zyra e prokurorit disiplinor ka juridiksion ndaj çështjes;
 - 1.3 për hetimin e çdo fletëparaqitje, ndaj të cilës ka juridiksion;
 - 1.4 për raportimin e rezultateve të hetimit Komisionit disiplinor;
 - 1.5 në rastet kur Zyra e prokurorit disiplinor përcakton ekzistimin e arsyes së bazuar për ndjekje disiplinore, për përfaqësimin e interesave të OAK-ut në ndjekjen disiplinore të çështjes para Komisionit disiplinor.

Neni 10 Punonjësit

Zyra e prokurorit disiplinor përbëhet nga prokurori disiplinor dhe punonjësit e tjerë, të cilët konsiderohen si të nevojshëm.

Neni 11

Prokurori disiplinor

1. Prokurori disiplinor zgjidhet nga Bordi Drejtues i OAK. Vendi i lirë i punës plotësohet në bazë të një procesi konkurrues pas shpalljes së konkursit për këtë pozitë.
2. Prokurori disiplinor është përgjegjës për hetimin dhe ndjekjen disiplinore efikase dhe të efektshme dhe ushtron përgjegjësisë e tij në pajtim me Kodin e etikës së avokatëve Statutit dhe rregulloret e miratuara nga OAK-ja.
3. Prokurori disiplinor merre pagën që përcaktohet nga OAK-ja. Prokurori nuk merr kompensim tjetër, përveç kompensimit për shpenzimet e arsyeshme dhe të nevojshme, që dalin nga detyrat e punës.

Neni 12

Kualifikimet e Prokurorit disiplinor

1. Prokurori disiplinor duhet t'i plotësojë kualifikimet vijuese:
 - 1.1. të jetë shtetas i Kosovës;
 - 1.2. të ketë diplomë të vlefshme universitare nga fusha e drejtësisë;
 - 1.3. të ketë dhënë provimin e jurisprudencës në Republikën e Kosovës;
 - 1.4. të ketë së paku 3 vite përvojë pune në lëmine juridike;
 - 1.5. të ketë reputacion pozitiv profesional dhe integritet moral;
 - 1.6. të mos jetë dënuar për vepra penale apo kundërvajtjeve që e bëjnë të padenjë për pozitën e Prokurorit disiplinor.

Neni 13

Buxheti i Zyrës së Prokurorit disiplinor

Prokurori Disiplinor çdo vjet ia parashtron Këshillit Drejtues të OAK-së një buxhet të ndarë për financimin e pagave të punonjësve të Zyrës së Prokurorit disiplinor dhe për shpenzimet e tjera të punës të Zyrës. Buxheti i Zyrës administrohet nga OAK-ja, sipas udhëzimeve dhe vërtetimit të Prokurorit disiplinor. OAK-ja nuk ka autorizime që t'i kufizojë apo t'i drejtojë shpenzimet e Zyrës së Prokurorit disiplinor e as që do të ketë autorizime për të rindarë buxhetin e Zyrës ose për të shfrytëzuar fondet e ndara Zyrës së Prokurorit disiplinor për çfarëdo qëllimi tjetër. Prokurori disiplinor i raporton çdo vit Këshillit Drejtues të OAK-së lidhur me aktivitetet dhe shpenzimet të Zyrës së Prokurorit disiplinor.

Neni 14

Procedura

Çdo person mund të kërkojë zhvillimin e hetimeve ndaj një avokati apo praktikanti të avokatisë. Fletëparaqitja e bërë në cilëndo zyrë të OAK menjëherë i dërgohet Zyrës së Prokurorit disiplinor.

Neni 15

Fletëparaqitja

1. Çdo fletëparaqitje bëhet me shkrim dhe së paku përfshinë:
 - 1.1. emrin, adresën dhe numrin e telefonit të personit që kërkon zhvillimin e hetimeve;
 - 1.2. emrin, adresën dhe numrin e telefonit të avokatit apo praktikantit që do të hetohet;
 - 1.3. përshkrimin e sjelljes, për të cilën kërkohet hetimi;

1.4. çfarëdo dokumenti tjetër përcjellës.

2. Zyra e Prokurorit Disiplinor mund t'i ndihmojë palës kërkuese të procedurës për hetim disiplinor në përgatitjen e fletëparaqitjes, por vetëm për t'u siguruar që fletëparaqitja të përmbajë informata të mjaftueshme për hetime. Zyra e Prokurorit Disiplinor nuk i ndihmon palës kërkuese lidhur me pretendimet substanciale.

Neni 16 **Shqyrtimi juridik**

1. Zyra e Prokurorit Disiplinor shqyrtton çdo fletëparaqitje për të përcaktuar nëse pretendimet, po që se janë të sakta, do të paraqisnin shkelje të Kodit të etikës së avokatëve. Nëse në fletëparaqitje pretendohet ekzistimi i fakteve të tilla, Zyra e Prokurorit Disiplinor fillon hetimet.

2. Nëse në fletëparaqitje pretendohen faktet, të cilat nëse dalin të vërteta, nuk do të përbënin shkelje, Zyra e prokurorit disiplinor refuzon hetimin e fletëparaqitjes dhe njofton parashtruesin e kërkesës për këtë refuzim.

Neni 17

1. Zyra e prokurorit disiplinor njofton avokatin në fjalë apo praktikantin lidhur me fillimin e hetimeve për të dhe kërkon përgjigje nga avokati apo praktikanti në fjalë.

2. Brenda tetë (8) ditëve nga pranimi i njoftimit, avokati apo praktikanti i paraqitur ia dorëzon Zyrës së Prokurorit Disiplinor përgjigjen me shkrim ndaj çështjeve të ngritura në fletëparaqitje. Përgjigja duhet të përfshijë dokumentacionin, përmes të cilit mbështetet qëndrimi i avokatit apo praktikantit.

3. Mosdhënia me kohë e përgjigjes nga avokati ndaj fletëparaqitjes nënkupton pranimin e avokatit për zhvillimin e procedurës para Komisionit disiplinor.

Neni 18 **Hetimi**

1. Zyra e Prokurorit Disiplinor ka kompetenca për kërkimin dhe marrjen e dëshmive nga cilido person që mund të jetë në dijeni për faktet e nevojshme lidhur me çfarëdo çështjeje që i nënshtrohet hetimit.

2. Çdo anëtar OAK-së, duke përfshirë avokatin apo praktikantin e avokatisë, ndaj të cilit zhvillohet hetimi, obligohet për dhënien e dëshmive që kërkohen nga Zyra e Prokurorit Disiplinor. Ankesat dhe vërejtjet lidhur me fushëveprimin e hetimit apo me metodat për hetimin e çështjes i dërgohen Zyrës së Prokurorit Disiplinor, si instancë e parë. Për kontestet dhe vërejtjet që nuk mund të zgjidhen në kuadër të Zyrës së Prokurorit disiplinor, mund të parashtrohet ankesa tek Komisioni disiplinor.

Neni 19 **Raporti i hetimeve**

1. Pas përfundimit të çdo hetimi, Zyra e Prokurorit Disiplinor përgatitë raportin e hetimeve dhe ia dërgon Komisionit Disiplinor. Ky raport përfshinë si në vijim:

- 1.1. emrin, adresën dhe numrat e telefonit të parashtruesit të kërkesës dhe të avokatit apo praktikantit nën hetim;
- 1.2. përmbledhjen e fakteve, duke përfshirë fletëparaqitjen, përgjigjen dhe çfarëdo dokumentacioni relevant përcjellës, të dhënë nga palët apo të marrë gjatë hetimeve.
- 1.3. rekomandimin e Zyrës së Prokurorit Disiplinor lidhur me atë nëse ekziston arsyeja e bazuar apo jo për shqyrtimin e çështjes, apo nëse është e duhur shtyrja e shqyrtimit, ashtu siç parashihet në nenin 20.

Neni 20 Shtyrja

Në rastet kur nga dëshmitë shihet se ka pasur shkelje të lehtë dhe kur avokati pajtohet që të korrigojë çfarëdo dëmi të shkaktuar ndaj klientit, Zyra e Prokurorit Disiplinor mund t'i rekomandojë Komisionit Disiplinor që procedura të shtyhet për një periudhë kohore deri në një vit për t'ia mundësuar avokatit që të vazhdojë punën sipas kushteve të shqiptuara nga Zyra e Prokurorit Disiplinor. Nëse avokati i respekton të gjitha kushtet gjatë periudhës së shtyrjes, lënda do të përfundojë dhe nuk do të kërkohet ndonjë masë disiplinore.

Komisioni disiplinor

Neni 21 Përgjegjësitë

1. Komisioni disiplinor është përgjegjës:

- 1.1 për shqyrtimin e çdo raporti hetimor;
- 1.2 për miratimin apo refuzimin e rekomandimit të Zyrës së Prokurorit Disiplinor lidhur me atë se a ekziston apo jo arsyeja e bazuar për shqyrtimin e çështjes;
- 1.3 për udhëheqjen e procedurës disiplinore ndaj avokatëve dhe praktikanteve, të paraqitur për shkelje të etikës profesionale.

Neni 22 Paneli disiplinor

1. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga pranimi i raportit nga Zyra e prokurorit disiplinor, kryesuesi i Komisionit disiplinor cakton panelin disiplinor, i cili përbehet prej tre (3) anëtarëve të Komisionit disiplinor. Njëri nga anëtarët caktohet si kryesues i panelit. Paneli do të veprojë ndaj rastit sipas procedurës së paraparë.
2. Nëse anëtari i panelit nuk është në gjendje të kryejë detyrën apo nëse ka bazë të arsyeshme për një gjë të tillë, ai njofton me shkrim kryesuesin e Komisionit disiplinor lidhur me pamundësinë e tij për kryerjen e detyrës. Njoftimi duhet t'i jepet kryesuesit të Komisionit disiplinor brenda tri ditëve nga emërimi i panelit.
3. Ushtruesi i fletëparaqitjes dhe i paraqituri kanë të drejtë të kërkojnë largimin e anëtarit të panelit pas paraqitjes së arsyes së fortë për një gjë të tillë kryesuesit të Komisionit disiplinor të shqyrtimit brenda tri ditësh nga marrja e njoftimit nga anëtarët e panelit.
4. Kryesuesi i Komisionit disiplinor të shqyrtimit zëvendëson anëtarët e diskualifikuar apo ata që nuk janë në dispozicion brenda tri ditëve pasuese.

Neni 23

Shqyrtimi fillestar i panelit disiplinor

1. Brenda shtatë (7) ditëve nga caktimi në panelin disiplinor, çdo anëtar duhet të shqyrtojë raportin hetimor, të hartuar nga Zyra e Prokurorit Disiplinor, dhe të njoftojë kryesuesin e Komisionit disiplinor nëse mendon se ekziston apo nuk ekziston arsyeja e bazuar për fillimin e procedurës disiplinore për çështjen në fjalë.
2. Nëse shumica e anëtarëve të panelit përcaktojnë ekzistimin e arsyes së bazuar për vazhdimin e procedurës disiplinore, kryesuesi i panelit harton vendimin me shkrim, përmes të cilit fillon procedura disiplinore për çështjen në fjalë. Kopjet e vendimit me shkrim i dërgohen ushtruesit të fletëparaqitjes, të paraqiturit, Zyrës së Prokurorit disiplinor dhe kryesuesit të Komisionit disiplinor.
3. Nëse shumica e anëtarëve të panelit konstatojnë se nuk ekziston arsye e bazuar për fillimin e procedurës disiplinore, kryesuesi i panelit harton vendim me shkrim për hedhjen poshtë të lëndës. Kopjet e urdhrit me shkrim i dërgohen ushtruesit të fletëparaqitjes, të paraqiturit, Zyrës së Prokurorit disiplinor dhe kryesuesit të Komisionit disiplinor të shqyrtimit. Si bazë në përcaktimin se nuk ekziston arsyeja e bazuar për fillimin e procedurës disiplinore është:
 - 3.1. Veprimet e të paraqiturit, i cili i nënshtrohet shqyrtimit sipas fletëparaqitjes, nuk përbëjnë shkelje të rregullave të etikës profesionale të avokatëve;
 - 3.2. Ekzistojnë rrethanat që përjashtojnë përgjegjësinë disiplinore;
 - 3.3. Ekziston vendimi i formës së prerë nga organet disiplinore për të njëjtën çështje (*ne bis in idem*);
 - 3.4. Afati i parashkrimit për parashtrimin e fletëparaqitjes për fillimin e procedurës disiplinore ka kaluar sipas Ligjit për Avokatinë.

Neni 24

Fillimi i shqyrtimit disiplinore

1. Paneli disiplinor udhëheq me shqyrtimin e lëndëve disiplinore.
2. Zyra e Prokurorit Disiplinor bën përfaqësimin e lëndës disiplinore para Panelit disiplinor.
3. Paneli disiplinor fton të paraqiturin dhe avokatin e tij (nëse është i angazhuar) në seancën kryesore dëgjimore në pajtim me nenin 25 të kësaj rregulloreje . Paneli disiplinor ia jep raportin hetimor të paraqiturit, duke përfshirë edhe dëshmitë ekzistuese për rastin.
4. Dëshmitarët dhe ekspertët, nëse ka, ftohen në seancën kryesore dëgjimore në rast se Paneli disiplinor konsideron se ata mund t'i ndihmojnë rastit nën shqyrtim përmes dëshmimeve, përkatësisht ekspertizës së tyre.

Neni 25

Ftesa

1. Palët në procedurë ftohen së paku 8 ditë para seancës kryesore dëgjimore.
2. Ftesa përmban datën, kohën dhe vendin e seancës kryesore dëgjimore, si dhe informatën për çështjen nën shqyrtim.

3. Përmes ftesës i paraqituri informohet si në vijim:
 - 3.1. për të drejtën që të përfaqësohet nga avokati;
 - 3.2. që seanca kryesore nuk shtyhet për shkak të mos pranisë së avokatit apo mos angazhimit të avokatit nga i paraqituri;
 - 3.3. për vazhdimin e seancës dëgjimore pavarësisht nëse i paraqituri merr pjesë apo jep dëshmi në të.
4. Nëse palët ftohen në mënyrë të duhur dhe nuk vijnë në seancë apo nuk arsyetojnë mungesën e tyre, seanca kryesore do të mbahet edhe në mungesë të tyre.

Neni 26 **Caktimi i avokatit**

1. Në rastin kur i paraqituri nuk mund të paguajë avokatin dhe kur në interes të drejtësisë kërkohet që i njëjti të përfaqësohet, dhe në të gjitha rastet ku pretendohen shkelje të rënda të rregullave të etikës, për të cilat masa e pezullimit të licencës mund të shqiptohet për periudhën prej 6 muaj deri në 5 vjet, me kërkesë të paraqiturit, Paneli disiplinor mund të caktojë avokatin, i cili paguhet nga buxheti i OAK-së.
2. Avokati i caktuar nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mund të jetë anëtar i asnjë komisioni disiplinor apo anëtar i Këshillit Drejtues të OAK-së.
3. Avokati i caktuar gëzon të gjitha të drejtat dhe autorizimet për të përfaqësuar të paraqiturin, sikurse i njëjti të ishte angazhuar nga i paraqituri.

Neni 27 **Seanca kryesore – koha dhe vendi**

1. Seanca kryesore me rregull mbahet në zyrën të OAK-së në Prishtinë.
2. Paneli disiplinor, me pajtimin e kryesuesin e Komisionit disiplinor, mund të vendosë që të seanca kryesore dëgjimore të mbahet jashtë zyrës kryesore të OAK-së, në cilëndo prej zyrave regjionale të OAK-së apo në cilindo vend tjetër, nëse përmes këtij veprimi sigurohet prania e palëve, dëshmitarëve dhe ekspertëve ose nëse grumbullimi i dëshmitarëve apo provave për lëndën është më i lehtë.
3. Kryesuesi i Panelit disiplinor në baza të arsyeshme mund të shtyjë datën e seancës kryesore nëse këtë e propozojnë palët, avokatët apo nëse propozimi bëhet sipas detyrës zyrtare.

Neni 28 **Pjesëmarrësit në Seancën kryesore dëgjimore**

1. Seanca kryesore dëgjimore mbahet pa praninë e publikut.
2. Me lejen e kryesuesit të Panelit, personat e tjerë nga ata që marrin pjesë në procedurë mund të marrin pjesë në seancën kryesore dëgjimore, duke përfshirë praktikantët, studentët e fakultetit juridik, profesionistët vetëm për qëllime profesionale dhe në interes të OAK.

Neni 29

Seanca kryesore dëgjimore – regjistrimi/transkriptimi i procedurave

1. Procedurat e seancës kryesore dëgjimore transkriptohen.
2. Nëse kushtet e lejojnë dhe me propozim të palëve, kryetari i OAK-së mund të urdhërojë bërjen e audio incizimit.
3. Transkriptet lexohen menjëherë pas kërkesës së palëve, kërkesës së avokatit dhe të kërkesës së personit, deklarata e të cilit regjistrohet në procesverbal.
4. Procesverbali nënshkruhet nga Prokurori disiplinor, i paraqituri apo avokati i tij, kryesuesi i Panelit disiplinor dhe procesmbajtësi.
5. Palët kanë të drejtë të shqyrtojnë procesverbalin përfundimtar, të japin komente lidhur me përmbajtjen, si dhe të kërkojnë korrigjime të tij.

Neni 30

Seanca kryesore dëgjimore – hapja e procedurës

1. Kryesuesi i panelit disiplinor hap seancën kryesore dëgjimore, shpall rastin dhe i informon të pranishmit për përbërjen e panelit dhe për përfaqësuesin e Zyrës së Prokurorit disiplinor, si dhe për palët e tjera në procedurë. Më pas, ai vërteton nëse të gjithë personat e ftuar janë të pranishëm në seancën dëgjimore dhe verifikon nëse ftesat janë dorëzuar dhe nëse është dhënë ndonjë arsytim në rast të mungesës.
2. Në rastet kur ftesa nuk është dorëzuar në mënyrën e duhur, paneli informon kryesuesin e Komisionit disiplinor, i cili më pas njofton Drejtorin Ekzekutiv të OAK-së.
3. Kryesuesi i panelit disiplinor fton Prokurorin Disiplinor që t'i lexojë akuzat disiplinore.

Neni 31

Seanca kryesore dëgjimore – udhëzimet për të paraqiturin

1. Pasi që kryesuesi i panelit disiplinor të përcakton se të gjithë personat e ftuar kanë ardhur në seancë apo pasi që paneli vendosë të fillojë me seancën kryesore dëgjimore pa praninë e ndonjërit prej personave të ftuar ose që të shtyjë vendimin për këto çështje, kryesuesi i panelit njofton të paraqiturin për të drejtat e tij.
2. Kryesuesi i paneli udhëzon të paraqiturin si në vijim:
 - 2.1. Se ai ka të drejtë të mos deklarohej për rastin e tij apo që të mos përgjigjet në asnjërën prej pyetjeve;
 - 2.2. Se ai ka të drejtë dhe se i lejohet të jep deklaratë për të gjitha faktet dhe dëshmitë kundër tij dhe të deklarojë faktet dhe dëshmitë që janë në favor të tij;
 - 2.3. Se ai ka të drejtë që t'i pyes dëshmitarët ose që t'i udhëzojë të tjerët ta bëjnë një gjë të tillë, si dhe të sigurojë pjesëmarrjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në favor të tij sipas kushteve të njëjta sikurse për dëshmitarët kundër tij;
 - 2.4. Se nëse ai deklarohej, atëherë nuk obligohet të inkriminojë vetveten apo të pranojë fajin;
 - 2.5. Se ai mund të mbrojë vetën personalisht apo përmes ndihmës juridike të avokatit sipas zgjedhjes së tij; .
 - 2.6. Se ai ka të drejtë në përkthim falas, nëse nuk e flet gjuhën në të cilën zbatohet procedura.

3. Kryesuesi i panelit fton të paraqiturin që të përcjellë me vëmendje seancën dëgjimore dhe e udhëzon atë se mund të paraqes fakte, t'u parashtrijë pyetje dëshmitarëve dhe ekspertëve, etj, si dhe të bëjë komente lidhur me dëshminë e tyre e të jap shpjegime për të.

Neni 32

Mos prezenca në Seancën kryesore dëgjimore

1. Nëse Prokurorit disiplinor apo ndonjë përfaqësues tjetër i Zyrës e Prokurorit Disiplinor, duke përfshirë edhe ndonjë palë tjetër në interes për ankuesin nuk paraqiten në seancë, paneli disiplinor hedh poshtë ndjekjen disiplinore dhe njofton me shkrim kryesuesin e Komisionit disiplinor të shqyrtimit, Zyrën për disiplinën e avokatëve dhe kryetarin e OAK-së.
2. Nëse i paraqituri ose përfaqësuesi i tij nuk paraqiten në seancë, paneli disiplinor konstaton të gjitha faktet në dobi të Zyrës së Prokurorit Disiplinor, merr vendimin se i paraqituri është fajtor dhe shqipton masën e duhur.
3. Nëse i paraqituri paraqitet në seancë, por avokati i tij nuk vjen edhe pse i ftuar në mënyrë të rregullt, dhe nuk jep arsyetim për këtë mungesë ose kur avokati del nga seanca dëgjimore pa lejen e panelit, seanca kryesore dëgjimore do të mbahet pa praninë e tij.
4. Nëse dëshmitarët apo ekspertët nuk paraqiten dhe nuk japin arsyetim për këtë mosparaqitje, edhe pse të ftuar në mënyrë të rregullt, seanca kryesore dëgjimore do të mbahet pa praninë e tyre. Nëse ata paraprakisht kanë dhënë deklaratat apo mendimet e tyre, seanca kryesore dëgjimore do të mbahet pa deklaratat a mendimet e tyre.

Neni 33

Standardi provës

1. Cilido i paraqitur, avokat apo praktikant, ndaj të cilit zhvillohet procedura disiplinore konsiderohet i pafajshëm deri në momentin kur përmes dëshmive konstatohet se i paraqituri ka bërë sjellje joprofesionale, i cili konstatim merret përmes vendimit të formës së prerë, të nxjerrë nga paneli disiplinor.
2. Çfarëdo dyshimi lidhur me ekzistimin e fakteve relevante për rastin apo për zbatimin e cilësdo rregull për rastin disiplinor interpretohet në favor të të paraqiturit dhe të drejtave të tij.
3. Çfarëdo mase disiplinore gjithmonë duhet të jetë në përputhje me shkallën e sjelljes joprofesionale. Konstatimet paraprake për sjellje joprofesionale brenda tri (3) viteve të kaluara mund të konsiderohen gjatë vlerësimit për shqiptimin e masës, por nuk mund të konsiderohen në përcaktimin nëse ka dëshmi për sjellje joprofesionale apo jo.
4. Shkeljet dhe masat disiplinore përcaktohen vetëm sipas mënyrës së paraparë në Ligjin për avokatinë, Statutin e OAK-së dhe në Kodin e etikës profesionale.
5. Askush nuk mund t'i nënshtrohet masës disiplinore për një veprim, e cila para kryerjes së saj nuk është konsideruar sipas ligjit apo normës përkatëse si shkelje e rregullave të etikës profesionale për avokatë dhe nëse nuk është paraparë asnjë dënim për shkelje të tillë.
6. Në rast të çfarëdo dyshimi, përkufizimi i shkeljes disiplinore interpretohet në favor të të paraqiturit dhe të drejtave të tij.

Neni 34

Mbajtja e rregullit gjatë seancës kryesore dëgjimore

1. Detyra kryesore e kryesuesit të panelit është që të sigurojë ruajtjen e rendit dhe qetësisë gjatë seancës.
2. Menjëherë pas hapjes, ai mund t'i njoftojë të pranishmit që të sjellën në mënyrë të duhur dhe që të mos pengojnë punën e panelit disiplinor.
3. Nëse ndonjë person nuk sillet në mënyrë të duhur pas tërheqjes së vërejtjes nga kryesuesi i panelit, paneli mund t'ia shqiptojë atij personi gjobën deri në 100,00 euro. Paneli gjithashtu mund të urdhërojë që personi të del apo të largohet nga salla ku mbahet seanca.
4. Paneli disiplinor mund të diskualifikojë avokatin apo përfaqësuesin e autorizuar të të paraqiturit nga përfaqësimi i të paraqiturit nëse edhe pas vërejtjes dhe dënimit personi vazhdon të prishë rendin. Diskualifikimi shqiptohet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. Avokati i diskualifikuar raportohet tek Zyra e prokurorit disiplinor për qëllime të hetimit të sjelljes joprofesionale.
5. Nëse avokati i të paraqiturit diskualifikohet, seanca dëgjimore vazhdon përveç nëse avokati i të paraqiturit është emëruar sipas nenit 26 të kësaj Rregulloreje. Në rastet kur avokati i të paraqiturit është caktuar, i paraqituri mund të kërkojë shtyrjen e seancës dëgjimore.
 - 5.1. Shtyrja bëhet për jo më shumë se tetë (8) ditë, dhe i paraqituri paguan kostot dhe shpenzimet e ndërlidhura me të.
 - 5.2. Nëse përfaqësuesi i Zyrës së Prokurorit disiplinor prish rendin, ai menjëherë raportohet tek Drejtori ekzekutiv për hetimin e sjelljes joprofesionale.

Neni 35

Paraqitja e dëshmive

1. Paraqitja e dëshmive përfshinë të gjitha faktet që paneli i konsideron të rëndësishme për marrjen e vendimit në mënyrë të duhur dhe të drejtë.
2. Paraqitja e dëshmive para marrjes në pyetje të paraqiturit bëhet në praninë e të paraqiturit.
3. Dëshmitë paraqiten sipas renditjes së përcaktuar nga kryesuesi i panelit. Si rregull, dëshmitë e propozuara nga ushtruesi i fletëparaqitjes paraqiten të parat, të pasuara nga dëshmitë e paraqitura nga i paraqituri dhe në fund paraqiten dëshmitë, për të cilat paneli ka urdhëruar që të merren sipas detyrës zyrtare.
4. Pas fillimit të seancës dëgjimore, dhe në rast se palët nuk e kanë bërë këtë fillimisht, palët ia qartësojnë panelit kërkesat e tyre për dëshmitë që propozojnë t'i ndërmarrin.
5. Palët nuk kanë të drejtë në ankesë të veçantë.

Neni 36

Marrja në pyetje e dëshmitarëve dhe ekspertëve nën betim

1. Para marrjes në pyetje të dëshmitarit, kryesuesi i panelit e njofton dëshmitarin për detyrën e tij për të treguar të vërtetën dhe për pasojat ligjore që bart dëshmia e rrejshme.

2. Paneli disiplinor mund të kërkojë nga dëshmitari që të bëjë betimin. Betimi i dëshmitarit është si në vijim: “Duke qenë i/e vetëdijshëm për rëndësinë e dëshmisë dhe për përgjegjësinë time ligjore, betohem solemnisht se do të tregoj të vërtetën, vetëm të vërtetën dhe asgjë përveç të vërtetës, dhe se nuk do të fsheh asgjë, për të cilën kam njohuri.”

3. Para fillimit të marrjes në pyetje të dëshmitarit eksperti, kryesuesi i panelit mund t’i kërkojë që të jep betimin. Betimi i ekspertit dëshmitar është si në vijim: Duke qenë i/e vetëdijshëm për rëndësinë e dëshmisë dhe për përgjegjësinë time ligjore, betohem solemnisht se do të zbatojë analizën time të ekspertit me ndërgjegje dhe ashtu si di më së miri, si dhe do të deklarojë konstatimet dhe mendimin tim në mënyrë të saktë dhe të plotë”.

4. Gjatës seancës palët kanë të drejtën e parashtrimit të pyetjeve dëshmitarit apo ekspertit.

5. Pala e parë që do të parashtron pyetjet do të jetë Zyra e Prokurorit Disiplinor, pastaj i paraqituri dhe avokati i tij (nëse ka) dhe në fund pyetjet i bën paneli disiplinor.

6. Pas përfundimit të procedurave të dëshmive, kryesuesi i panelit disiplinor fton palët që të paraqesin fjalën e tyre përfundimtare.

Neni 37

Marrja në pyetje e ekspertëve

1. Eksperti ia komunikon gojarisht konstatimin dhe mendimin e tij panelit.
2. Nëse eksperti ka hartuar raport për konstatimet e tij para mbajtjes së seancës dëgjimore, ai mund ta lexojë atë, me ç’ rast raporti futet në dosje.

Neni 38

Mbrojtja e të paraqiturit

1. I paraqituri merret në pyetje me gojë pas paraqitjes së dëshmive në praninë e tij. Gjatë shqyrtimit ai mund të lejohet t’i shfrytëzojë shënimet dhe dëshmitë në përkrahje të mbrojtjes së tij.
2. Gjatë marrjes në pyetje të paraqiturit duhet t’i jepet mundësia për eliminimin e bazës për dyshim kundër tij dhe për t’i vërtetuar faktet që janë në favor të tij.
3. Marrja në pyetje realizohet me respekt të plotë ndaj dinjitetit të të paraqiturit.
4. Të paraqiturit pyetjet i parashtrohen në mënyrë të qartë, të shkoqitur dhe të saktë. Pyetjet për të paraqiturin nuk duhet të nisen nga supozimi se i paraqituri ka pranuar diçka që nuk e ka pranuar.
5. Nëse marrja në pyetje e të paraqiturit është bërë në kundërshtim me dispozitat e ligjit, statutit dhe të kësaj rregulloreje, si dhe me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale që kanë të bëjnë me pranueshmërinë e dëshmive, ajo marrje në pyetje është e papranueshme dhe nuk mund të përdoret si dëshmi kundër të paraqiturit.

Neni 39

Deklaratat përmbyllëse

1. Pas përfundimit të procedurave të dëshmive, kryesuesi i panelit fton palët dhe

- përfaqësuesit e tyre që t'i përmbledhin argumentet e tyre. Zyra e Prokurorit Disiplinor flet e para, pastaj ankuesi mund të parashtrojë deklaratën, duke pasuar me avokatin e të paraqiturit dhe në fund deklaratën e jep i paraqituri.
2. Pas paralajmërimit, paneli disiplinor mund të ndërpresë folësin, i cili flet gjatë dhe panevojshëm për çështjet jo relevante për rastin.
 3. Përpos paraqitjes me gojë, palët mund të paraqesin deklaratat e tyre përmbyllëse edhe me shkrim.
 4. Në deklaratat e tyre përmbyllëse, palët mund të paraqesin vlerësimin e vet të dëshmive, të grumbulluara në seancën kryesore dëgjimore, dhe të shpjegojnë përfundimet e tyre lidhur me faktet e rëndësishme për vendimin, si dhe të paraqesin dhe justifikojnë propozimet e tyre lidhur me përgjegjësinë disiplinore të paraqiturit, etj., si dhe të propozojnë rrethana lehtësuese apo rënduese që duhet të merren parasysh gjatë shqyrtimit të masës disiplinore nga paneli.
 5. Për shkelje të rënda që nënkuptojnë dënime më të rënda, siç është ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të profesionit për periudhën prej 6 muaj deri në 5 vjet, përfaqësuesi i Zyrës së Prokurorit Disiplinor propozon masën, për të cilin ai mendon se duhet t'i shqiptohet të paraqiturit.
 6. I paraqituri gjithmonë ka të drejtën të flet i fundit.
 7. Nëse pas deklaratave përmbyllëse të palëve paneli disiplinor nuk sheh nevojën për ndonjë dëshmi tjetër, kryesuesi i panelit deklaron përfundimin e seancës.

Neni 40 **Shqyrtimet dhe seanca e votimit**

1. Paneli disiplinor vendos dhe nxjerr vendimin e vet pas shqyrtimit dhe votimit në seancë.
2. Paneli disiplinor bazon vendimin e vet vetëm në fakte dhe dëshmi të shqyrtuara në seancën kryesore dëgjimore.
3. Paneli është i obliguar të bëjë vlerësim të ndërgjegjshëm të çdo pjese të dëshmisë veç e veç dhe në ndërlidhje me pjesët e dëshmive të tjera, ku në bazë të atij vendimi, të arrijë te përfundimi nëse është konstatuar një fakt i caktuar apo jo, apo nëse është përcaktuar fajësia e të paraqiturit apo jo sipas standardit të dëshmisë, të paraparë në nenin 33.
4. Gjatë marrjes së vendimit për çështjen kryesore, së pari votohet nëse i paraqituri ka shkelur Statutin e OAK-së, në bazë të konstatimeve të panelit disiplinor, çfarë shkelje është bërë pavarësisht se çka pretendohet në fletëparaqitjen disiplinore, pastaj votohet për masën disiplinore, për shfajësimin, për shpenzimet e procedurës dhe për çështjet e tjera që duhet të vendosen.
5. Paneli disiplinor mban procesverbalin e shqyrtimit dhe të votimit.
6. Procesverbali i shqyrtimit dhe të votimit:
 - 6.1. përmban faktet e shqyrtuara nga paneli me rastin e nxjerrjes së vendimit dhe cilat janë konsideruar si të vërtetuara dhe cilat si të pavërtetuara, nëse ka pasur të tilla;

- 6.2 përmban masat disiplinore që paneli disiplinor i konsideron si të duhura.
- 6.3. konstaton nëse vendimi është marrë njëzëri apo nëse ka pasur mendime të ndryshme nga cilido prej anëtarëve të panelit;
- 6.4. përfshinë mendimin e ndryshëm;
- 6.5 përfshinë vendimin e panelit për shpenzimet procedurale;
- 6.6. nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e panelit, futet në zarfën e mbyllur dhe mbahet në dosjen e lëndës.

Neni 41 **Vendimi me shkrim**

1. Paneli autorizon kryesuesin e panelit për të hartuar vendimin me shkrim dhe arsyetimin e tij.
2. Vendimi me shkrim do të jetë në përputhje të plotë me vendimin që i është shpallur palëve. Vendimi përmban hyrjen, dispozitivin, dhe arsyetimin.

2.1. Hyrja përfshinë: emërtimin e organit (autoritetit) që merr vendimin; emrin dhe mbiemrin e kryesuesit, të anëtarëve të panelit disiplinor dhe të procesmbajtësit; emrin dhe mbiemrin e të paraqiturit, shkelja disiplinore për të cilën ai është paraqitur dhe nëse ai ka qenë i pranishëm në seancë apo jo në ditën e seancës kryesore dëgjimore; emrin dhe mbiemrin e përfaqësuesit të Zyrës së Prokurorit disiplinor, të ushtruesit të fletëparaqitjes, të avokatit të të paraqiturit (nëse ka), të përfaqësuesit ligjor dhe atij të autorizuar të pranishëm në seancën kryesore dëgjimore dhe ditën e shpalljes së vendimit.

2.2. Dispozitivi i vendimit përmban të dhënat personale të të paraqiturit: emrin dhe mbiemrin, adresën e vendbanimit dhe të avokaturës së tij, si dhe vendimin përmes të cilit i paraqituri shpallet përgjegjës për shkeljen disiplinore apo për të cilën ai lirohet nga fletëparaqitja disiplinore. Në rast të disa shkeljeve për të cilat i paraqituri akuzohet dhe për të cilat shpallet përgjegjës, në dispozitivin e vendimit paneli disiplinor ceket masat për secilën shkelje dhe më pastaj ceket masat e plota – masa e njësuar disiplinor.

2.3. Në pjesën e vendimit ku jepet arsyetimi paraqitet bazë për çdo pikë veç e veç të vendimit të nxjerrë. Vendimi me shkrim përfshinë udhëzimin e panelit për vendosjen e vendimit të formës së prerë në vendin për shpalljen e njoftimeve të OAK-së. Nëse i paraqituri merr masën e ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë së avokatit për periudhën prej 6 muaj deri në 5 vjet, vendimi përfshinë edhe udhëzimin e panelit për njoftimin e institucioneve gjyqësore, të gjykatave, prokurorive publike në të gjitha nivelet e Kosovës.

Neni 42 **Gjobat e shqiptuara**

1. Nëse i paraqituri dënohet me gjobë, në vendim ceket shuma e gjobës dhe afati, brenda të cilit gjoba duhet të paguhet, si dhe paralajmërimi se nëse gjoba dhe shpenzimet procedurale nuk paguhen brenda afatit të përcaktuar nga OAK-ja, atëherë do të konsiderohet se i paraqituri ka kryer shkelje të rëndë të detyrave të avokatit dhe sipas procedurës së shkurtër i paraqituri do të dënohet me një dënim më të rëndë, siç është ai i ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë së avokatit për periudhë kohore prej 6 muaj deri në 5 vjet.

2. Nëse i paraqituri dënohet me gjobë deri në 250 euro, dhe gjendja e tij financiare është e dobët ku gjoba nuk mund të përmbahet pa e futur atë dhe familjen e tij në gjendje të vështirë financiare, paneli disiplinor mund të vendos të zëvendësojë këtë dënim me gjobë me një dënim tjetër, siç është, p.sh. obligimi për dhënie të shërbimeve falas për njerëzit në nevojë në territorin ku ai ushtron profesionin e avokatit, duke ia përcaktuar numrin e orëve dhe shërbimeve që do të ofrohen.

3. Për shërbimet e ofruara sipas paragrafit 2 të këtij neni, i paraqituri duhet të mbajë regjistrin me shkrim dhe ta informojë kryetarin e zyrës regjionale të OAK-së, i cili do të mbikëqyrë ofrimin e këtyre shërbimeve, si dhe do ta informojë panelin disiplinor të OAK-së.

Neni 43 **Shpallja e vendimit**

1. Pas shqyrtimit dhe votimit, paneli disiplinor shpall vendimin në praninë e palëve.
2. Pas shpalljes së vendimit, kryesuesi i panelit njofton palët se do të marrin një kopje me shkrim të vendimit brenda 15 ditëve dhe do t'i udhëzojë palët për të drejtën e tyre të ankesës.

Neni 44 **Ankesa ndaj vendimit të Komisionit shqyrtues disiplinor**

1. Secila palë mund të parashtrojë ankesë në Komisionin disiplinor të ankesave të OAK-së kundër vendimit të nxjerrë nga paneli disiplinor. Kjo ankesë mund të parashtrohet brenda tetë (8) ditësh nga dita e pranimi të vendimit me shkrim.
2. Ankesa i drejtohet OAK-së, me referencën “Për Komisionin disiplinor të ankesave”, së bashku me një kopje për kryesuesin e Komisionit disiplinor të shqyrtimit.

Neni 45 **Ankesa**

1. Përveç të dhënave për ankuesin dhe për vendimin e ankimuar, ankesa përmban si në vijim:
 - 1.1. Bazën për kundërshtimin e vendimit në fjalë;
 - 1.2. Shpjegimin e ankesës;
 - 1.3. Propozimin për anulimin e plotë apo të pjesshëm të vendimit ose për modifikimin e tij;
 - 1.4. Propozimin për rishqyrtimin e rastit dhe
 - 1.5. Nënshkrimin e ankuesit.
2. Dëshmitë dhe faktet e reja mund të paraqiten në ankesë, por ankuesi obligohet të jep arsyet për mosparaqitjen e tyre të deritanishme. Nëse i referohet fakteve të reja, ankuesi tregon dëshmitë, përmes të cilave këto fakte të reja mund të vërtetohen, dhe gjatë referimit në dëshmi, ai tregon faktet që ka për qëllim t'i dëshmojë përmes asaj dëshmie.

Neni 46 **Baza për ankesë**

1. Vendimi i panelit disiplinor mund të ankimohet në bazë të si në vijim:
 - 1.1. Shkeljes së rëndë të dispozitave të Ligjit për avokatinë, të Statutit dhe të kësaj Rregulloreje;
 - 1.2. Shkeljes së ligjit material;
 - 1.3. Përcaktimit të gabueshëm apo jo të plotë të gjendjes faktike;
 - 1.4. Vendimit për masën disiplinor dhe për masën shtesë;
 - 1.5. Vendimit rreth shpenzimeve procedurale dhe
 - 1.6. Vendimin për publikimin e vendimit për masën e shqiptuar.
2. Ankuesi duhet të jep shpjegime të arsyeshme për secilën prej bazave të lartcekura.
3. Vendimi i panelit disiplinor nuk mund të kundërshtohet në bazë të përcaktimit të

gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike në rastet kur i paraqituri ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e fletëparaqitjes disiplinore dhe paneli disiplinor ka pranuar atë pranim të fajësisë.

Komisioni për Ankesa

Neni 47 Përgjegjësitë

1. Komisioni për Ankesa është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave disiplinore dhe ankesave kundër vendimeve të Këshillit Drejtues.

Neni 48 Procedimi i ankesës

1. Pas pranimit të ankesës, zyrtari i zyrës disiplinore të OAK-së regjistron ankesën në regjistrin e ankesave.
2. Kryesuesi i Komisionit disiplinor informohet për ankesën jo më vonë se 5 ditë nga dita e regjistrimit të saj në OAK.
3. Për çdo ankesë krijohet një dosje e veçantë, ku në kopertinën e saj shënohen emërtimet e parashtrësve të bashkëngjitura në ankesë dhe numri i faqeve.

Neni 49 Shqyrtimi fillestar

1. Kryesuesi i Komisionit për Ankesa shqyrton çdo ankesë. Nëse ankesa nuk përmban elementet e kërkuara sipas rregullave aktuale, atëherë brenda 5 ditësh i kthehet ankuesit për ta rregulluar atë.
2. Nëse ankesa nuk parashtrohet brenda afatit të paraparë prej 8 ditësh nga e pranimit të vendimit apo nëse ankesa parashtrohet nga personi i paautorizuar, kryesuesi i Komisionit disiplinor hedh poshtë ankesën.

Neni 50 Njoftimi i ankuesit

1. Nëse ankesa i plotëson kushtet sipas këtyre rregullave, kryesuesi i Komisionit disiplinor, përmes zyrtarit të zyrës disiplinore, ia dërgon palës kundërshtare brenda 8 ditësh ankesën së bashku me dokumentet e tjera përcjellëse për përgjigje.
2. Pala kundërshtare mund t'iu përgjigjet ankesës me shkrim brenda 8 ditëve nga dita e dorëzimit të ankesës.
3. Nëse përgjigja në ankesë nuk parashtrohet brenda afatit të paraparë, konsiderohet se pala ka hequr dorë nga drejta e tij për përgjigje në ankesë.
4. Pas skadimit të këtij afati, zyrtari i zyrës disiplinore brenda 5 ditësh referon ankesën dhe përgjigjen në të, nëse ka, si dhe dosjen e plotë të lëndës të dokumentacionit të regjistruar, tek Komisioni për ankesa i OAK-së për procedim të mëtejshëm.

Neni 51 Shqyrtimi i ankesës

1. Shqyrtimi i ankesës mbahet:
- 1.1. Në seanca të mbyllura dhe
- 1.2. Përmes seancave dëgjimore

Neni 52 Seancat e mbyllura

Ankesat kryesisht shqyrtohen në seanca të mbyllura, përveç në rastet kur anëtarët e Komisionit për ankesa apo pas propozimit të palëve konsiderojnë se për arsye të sqarimit më të mirë të rastit ka nevojë të organizohet seanca dëgjimore në praninë e palëve.

Neni 53 Seancat dëgjimore

1. Në rastet e seancave dëgjimore para Komisionit për ankesa, rregullat që vlejné për ftesën e palëve në seancë, pjesëmarrjen e tyre, mbrojtjen obliguese, mbajtjen e rendit, kohën dhe vendin e seancës, procesverbalin e seancës, shqyrtimin dhe votimin, që janë të njëjta me ato që vlejné para Komisionit Disiplinor.
2. Nëse palët e ftuara në mënyrë të rregullt nuk paraqiten, Komisioni mban seancën pavarësisht kësaj.
3. Komisioni për Ankesa aplikon përshtatshëm rregullat që zbatohen nga paneli disiplinor në seancë dëgjimore.
4. Procesverbalit të seancës dëgjimore para Komisionit për ankesa mbahet, duke përfshirë edhe Procesverbalin për shqyrtim dhe votim.
5. Seanca dëgjimore para Komisionit për ankesa fillon me raportimin e kryesuesit për faktet e procedurës.
6. Komisioni për ankesa mund të kërkojë nga palët që të jep shpjegime të nevojshme lidhur me pretendimet e tyre në ankesë.
7. Palët mund të propozojnë që dosjet e caktuara të lexohen si shtesë e raportit dhe mund të japin shpjegimet e nevojshme të qëndrimeve të tyre në ankesë apo në përgjigje të ankesës pa përsëritur përmbajtjen e raportit.
8. Procesverbalit të seancës duhet bashkëngjitur dosja e Zyrës së Prokurorit disiplinor dhe e Komisionit disiplinor.
9. Seanca dëgjimore para Komisionit për Ankesa mbahet vetëm atëherë kur ka nevojë për marrjen e dëshmimeve të reja apo të përsëriten dëshmitë të mëparshme të marra për shkak të përcaktimit të gabueshëm apo jo të plotë të gjendjes faktike, dhe kur ka baza të vlefshme për moskthimin e lëndës tek Komisioni Disiplinor për rishqyrtim.

Neni 54 Vendimi sipas ankesës

1. Komisioni për ankesa në seancë të mbyllur apo në seancë dëgjimore:

- 1.1. Mund të hedh poshtë ankesën si të paafatshme apo të papranueshme;
 - 1.2. Mund të refuzojë ankesën si të pabazë dhe të konfirmojë vendimin e shkallës së parë;
 - 1.3. Të anulojë vendimin dhe ta kthejë rastin në shkallën e parë për rishqyrtim dhe vendim ose
 - 1.4. Të modifikojë vendimin e ankimit dhe të marrë vendimin e vet sipas bazueshmërisë së lëndës.
2. Komisioni për ankesa vendos për të gjitha ankesat e palëve përmes një vendimi të vetëm.
 3. Vendimi i Komisionit për ankesa është i formës së prerë.
 4. Përmes vendimit, Komisioni për ankesa refuzon ankesën si të pabazë dhe konfirmon vendimin e shkallës së parë nëse përcakton se nuk ka bazë për ankimit dhe se nuk ka pasur shkelje të ligjit, të Statutit dhe të kësaj Rregullore.
 5. Përmes një vendimi, Komisioni për ankesa, gjatë pranimit të ankesës apo sipas detyrës zyrtare, anulon vendimin e shkallës së parë dhe e kthen lëndën për rishqyrtim nëse gjen se ekziston shkelje substanciale e rregullave procedurale dhe kur konsideron se sënjë e re dëgjimore para organit të shkallës së parë është e nevojshme për shkak të përcaktimit të gabueshëm apo jo të plotë të gjendjes faktike
 6. Komisioni për ankesa me vendim e anulon vendimin e shkallës së parë për arsye të përcaktimit të gabuar apo jo të plotë të fakteve edhe pse vendimi nuk ankimohet atë arsye nëse, gjatë shqyrtimit të ankesës, ngritën dyshime serioze rreth saktësisë së fakteve materiale që janë përcaktuar.
 7. Kur arsyeja e vetme për anulimin e vendimit të shkallës së parë është përcaktimi i gabuar i gjendjes faktike dhe kur e tëra që kërkohet për një përcaktim të drejtë është vlerësimi i ndryshëm i fakteve tashmë të përcaktuar dhe jo marrja e dëshmive të reja apo përsëritja e dëshmive të nxjerra më parë, Komisioni për ankesa e anulon vendimin dhe e nxjerrë një vendim duke u bazuar në meritat e rastit.
 8. Kur ankesa është paraqitur vetëm nga i paraqituri, Komisioni për ankesa gjithmonë e merr parasysh parimin juridik REFERMACIO IN PEIUS se ai nuk mund të nxjerrë një vendim më pak të favorshëm për palën ankuese për shkak të cilësimit të tij juridik të shkeljes dhe masës së shqiptuar.
 9. Komisioni për ankesa, gjatë pranimit të ndonjë ankese apo gjatë veprimit sipas detyrës zyrtare, e ndryshon vendimin nëse përcakton se faktet vendimtare janë përcaktuar në mënyrën e duhur, por duke e pas parasysh përcaktimin e gjendjes faktike një vendim tjetër është dashur të nxirrej sipas rrethanave të rastit.

Neni 55

Vendimi me shkrim rreth ankesës

1. Në deklaratën me shkrim rreth arsyeve për vendimin e tij, Komisioni për ankesa i vlerëson deklaratat që janë thelb i ankesës dhe i tregon shkeljet që i ka vërejtur gjatë shqyrtimit të ankesës.
2. Nëse vendimi anulohet për arsye të shkeljes substanciale të rregullave procedurale, deklarata e arsyeve e përmban një indikacion të shkeljeve që e bënë vendimin e paqëndrueshëm.

3. Nëse vendimi anulohet për arsye të përcaktimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, ne arsyetim tregohen mangësitë e përcaktimit faktik, apo të asaj se pse janë të rëndësishme dëshmitë dhe faktet e reja për nxjerrjen e një vendimi të drejtë dhe se pse ato kanë ndikim mbi atë vendim.

4. Komisioni për ankesa i kthen të gjitha dosjet tek organi i shkallës së parë së bashku me një numër të mjaftueshëm të kopjeve të vërtetuara të vendimit të tij që i jepen palëve dhe personave të tjerë të përfshirë.

Neni 56

Procedura në Komisionin disiplinor pas kthimit të lëndës në rishqyrtim

1. Gjatë rishqyrtimit, Komisioni disiplinor vepron në bazë të fletëparaqitjes paraprake disiplinore.
2. Palët kanë të drejtë që të paraqesin fakte dhe dëshmi të reja gjatë seancës dëgjimore të re.

Neni 57

Kompetenca e Komisionit për Ankesa vendimeve të Këshillit Drejtues

1. Komisioni për Ankesa vendos si organ i shkallës së dytë ndaj vendimeve të Këshillit Drejtues
2. Afati për ankesë kundër vendimeve të Këshillit Drejtues është 8 dite nga dita e pranimit të vendimit.
3. Procedura lidhur me ankesën kundër vendimeve të Këshillit Drejtues zhvillohet pershtatshmerisht me procedurën e shqyrtimit të ankesave disiplinore.
4. Vendimi i Komisionit për ankesë është i formës së prerë.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE HYRJA NË FUQI

Neni 58

Dispozitat kalimtare

1. Procedurat disiplinore të filluara para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje zhvillohen sipas rregullave që kanë qenë në fuqi në kohën kur ato kanë filluar.
2. Procedurat disiplinore të filluara pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje zhvillohen sipas kësaj rregulloreje.

Neni 59

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi i Odës së Avokatëve të Kosovës dhe zbatohet nga data 01 Janar 2014.

Av. Ibrahim Z. Dobruna
Kryetari i OAK-së